



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:017695
Datë: 20.12.2023
Numri i dokumentit: 05098115

PA1.nr. 214/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Pergjithshem, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Skender Çoçaj, anëtarë, me praktikantin gjyqësor Arben Arifi, si procesmbajtës në lëndën penale ndaj të akuzuarve Xh.M., nga fshati..., K. Suharekë, për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe të akuzuarit L.M., nga fshati ...c, K. Suharekë, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, për të vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit Xh.M., av. Miftar Qelaj, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, P.nr.249/22 të datës 05.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 12 Dhjetor 2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesërishëm të ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit Xh.M., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, P.nr.249/22 të datës 05.12.2022, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës të akuzuarit për veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 900 (nëntëqind) euro ndërsa të akuzuarit L.M., sipas detyres zyrtare (parimi Beneficium Cohesionis) për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro e të cilat dënime me gjobë do të ekzekutohen në afat prej 3 muajve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në dënimet e shqiptuara me gjobë do të iu llogaritet edhe koha e qëndrimit në arrest shtëpiak nga data 27.01.2022 deri me datë 15.02.2022.

Në pjesën tjetër aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë mbetet i pandryshuar.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, P.nr.249/22 të datës 05.12.2022, i akuzuari Xh.M., është shpallur fajtor për shkak të veprës Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, për të cilën i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve e në të cilin do t'i llogaritej edhe koha e qëndrimit në arrest shtëpiak nga data 27.01.2022 deri me datë 15.02.2022, e me pëlqimin e të akuzuarit dënimi i shqiptuar me burgim i është zëvendësuar në dënim me gjobe në shumë prej 1,500.00 (njëmijë e pesëqind euro). I akuzuari L.M., është shpallur fajtor për shkak të veprës Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, për të cilën i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve e në të cilin do t'i llogaritej edhe koha e qëndrimit në arrest shtëpiak nga data 27.01.2022 deri me datë 15.02.2022, e me pëlqimin e të akuzuarit dënimi i shqiptuar me burgim i është zëvendësuar në dënim me gjobe në shumë prej 700 (shtatëqind) euro.

Të akuzuarit janë obliguar secili veç e veç që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale që dalin sipas llogarisë përfundimtarë të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej nga 20 (njëzet) euro, në emër të taksës për kompensimin e viktimave të kërkuar shumen prej nga 30 (tridhjetë) euro si dhe për ekspertizën mjeko-ligjore shumen prej 50 (pesëdhjetë) e të gjitha këto pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të dëmtuarit N.M. dhe B.M., për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar :

Mbrojtësi i të akuzuarit Xh.M., av.Miftar Qelaj nga Prizreni, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje apo që i njëjti të ndryshohet dhe i akuzuari në mungesë të provave të lirohet nga akuza.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u skjaruar përkitazi me ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit Xh.M., me shkresën e vet PPA.II.nr. 255/23 të datës 14.02.2023 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit ta refuzojë si të pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në pajtim me nenin 390 paragrafi 1 të KPPRK-së, në të cilën prezantuan vetëm i akuzuari Xh.M., ndërsa palët e tjera munguan edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt, andaj seanca e kolegjit u mbajt në pajtim me nenin 390 paragrafi 4 të KPPRK-së. I akuzuari Xh.M. deklaroi se në tërësi e përkrah ankesën e ushtruar nga mbrojtësi i tij av.Miftar Qelaj dhe propozoi që e njëjta të aprovohet si e bazuar.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të mbrojtësit të të akuzuarit Xh.M., dhe gjeti se :

- Ankesa pjesërisht është e bazuar.

Sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale mbrojtësi i të akuzuarit Xh.M. me ankesë pretendon se aktgjykimi shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 nën paragrafi

1.12 te KPPRK-se ngase i njëjti nuk eshte i përpiluar me nenin 370 paragrafi 6 e 7 te KPPRK-se. Gjykata nuk ka paraqitur arsyet per çdo pike te aktgjykimit por ka shabllonizuar duke e përshkruar ngjarjen si ne dispozitivin e aktgjykimit ne raport me dispozitivin e aktakuzës. Sipas mbrojtësit të akuzuarit Gjykata e shkalles se pare ne aktgjykimin e ankimuar nuk i ka paraqitur ne mënyre te plote faktet e vërtetuara dhe te pa vërtetuara. Pretendon se dispozitivi i aktgjykimit eshte kundërthënës dhe i pakuptueshëm me brendinë e tij dhe arsyet e aktgjykimit.

Gjithashtu, pretendon se Gjykata e shkalles se pare ne aktgjykimin e kundërshtuar nuk ka paraqitur arsyerat për secilën pike veç e veç, nuk ka dhënë arsye lidhur me pretendimet e mbrojtjes në këtë çështje penale e të cilat shkelje aktgjykimin e shkalles se pare e bëjnë te paqëndrueshëm për çka të njëjtin duhet anuluar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerësoi pretendimet ankimore te mbrojtësit të të akuzuarit Xh.M., lidhur me shkeljet esenciale te dispozitave te procedurës penale dhe konstatoi se te njëjtat nuk janë te bazuara ngase aktgjykimi i ankimuar i gjykatës se shkalles se pare eshte i qarte dhe i kuptueshëm dhe si i tille përmban arsye te mjaftueshme përkitazi me faktet relevante te kësaj çështje juridiko penale si dhe faktet nga te cilat varet edhe aplikimi i drejte i dispozitave te ligjit penal. Theksimet e lartpërmendura ne ankese nuk janë te natyrës se tille per te konstatuar se aktgjykimi përmban mangësi te atilla procedurale qe do ta bënin te paqëndrueshëm ligjshmërinë e tij, andaj pretendimet ankimore lidhur me mos vërtetimin e fakteve vendimtare lidhur me këtë çështje, Gjykata e Apelit i refuzoi si te pabazuara.

Sa i përket vërtetimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike, mbrojtësi i të akuzuarit me ankesë pretendon se si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes se ligjit penal ne dem te te akuzuarit ka ardhur deri te vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike ngase nuk është vërtetuar fakti se i akuzuari e ka kryer vepren penale për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor, siç është pretenduar në aktakuzë e që këto fakte nuk janë vërtetuar as pas administrimit të provave dhe dëgjimit të dëshmitarëve respektivisht faktit se të gjitha veprimet që i ka ndërmarre Xh.M., janë veprime mbrojtjes per te shmangur sulmin dhe per te iu shmangur me te keqes dhe per qellim per te zmbropsur sulmin qe po vazhdonte ndaj tij dhe L.M., nga ana e B... dhe N.M., andaj gjykata sipas mbrojtësit të akuzuarin e ka shpallur fajtor pa u plotësuar elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerësoi pretendimet ankimore te mbrojtësit të të akuzuarit Xh.M. lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike dhe konstatoi se te njëjtat nuk janë te bazuara ngase janë ne kundërshtim me provat e administruara si : raporti fillestar i incidentit i datës 27.01.2022, raporti i oficerit Ibrahim Voci i datës 27.01.2022, procesverbali i intervistimit te te dyshuarit L.M. i datës 27.01.2022, procesverbali i intervistimit te te dyshuarit Xh.M. i datës 27.01.2022, procesverbali i marrjes ne pyetje i te pandehurit L.M. i datës 04.02.2022 të dhënë ne Prokurori, procesverbali i deklaratës se te pandehurit Xh.M. i datës 04.02.2022 të dhënë ne Prokurori, raporti mjekësor i datës 27.01.2022 per te dëmtuarit N.M., raporti mjekësor i datës 27.01.2022 per te dëmtuarit B.M., akt-ekspertimi mjeko-ligjor i ekspertit N.U., ka i datës 05.02.2022, deklarata e te dëmtuarit N.M. e dhënë ne shqyrtimin gjyqësore te datës 10.08.2022 dhe deklarata e te dëmtuarit B.M. e dhënë ne shqyrtimin gjyqësor te datës 10.08.2022 si dhe provat e tjera ne lëndë e ne baze te te cilave konstatohet se Gjykates se shkalles se pare, drejte dhe ne menyre te plote ka vërtetuar gjendjen faktike ne rastin konkret, andaj edhe pretendimet ankimore

lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike i refuzoi si të pabazuara si dhe konstatoi se në rastin konkret kur i akuzuari është shpallur fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar, drejte është aplikuar edhe ligji penal, ndërsa pretendimet e të mbrojtësit të të akuzuarit se i njëjti nuk e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar ngase ka vepruar në mbrojtje të nevojshme i refuzoi si të pabazuara e me qëllim të shmangies së përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, mbrojtësi i të akuzuarit Xh.M., konsideron se dënimi i shqiptuar është i kundërligjshëm ngase i akuzuari është dashur që të lirohet nga akuza. Megjithatë Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë e vlerësoi edhe në këte aspekt dhe konstatoi se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit me burgim e të zëvendësuar në dënim me gjobë nuk i ka vlerësuar në mënyrë të duhur rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së e të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e të cilat kanë ndikuar në shqiptimit të dënimit të lartë. Sipas mbrojtësit në rastin konkret gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit nuk e ka vlerësuar rrethanën lehtësuese si kontributin edhe të dëmtuarëve në këtë ngjarje, e për të cilat arsye edhe e ndryshoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë duke i shqiptuar dënim me gjobë më të ulët të akuzuarit e me bindje se me dënimin e shqiptuar nga ana e Gjykatës së Apelit, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, respektivisht parandalimi i kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i tij, parandalimi i personave tjerë nga kryerja e veprave penale dhe ngritja e moralit për respektimin e ligjit. Gjykata e Apelit aktgjykimin e shkallës së parë e ndryshoi edhe në raport me të akuzuarin e dytë L.M., bazuar në parimin Beneficium Cohesionis (neni 397 të KPPRK-së)

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 403 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.214/23 më 12.12.2023

Procesmbajtës
Arben Arifi

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetar i kolegjit
Zyhdi Haziri

Skender Çoçaj